



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 148

**Tiranë – E hënë, 10 gusht 2020**

## PËRMBAJTJA

|                                                                                       | Faqe                                                                                                                                                                                                                                                     |
|---------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 647, datë 30.7.2020                           | Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Kulturës, për mbulimin e shpenzimeve kapitale ..... 9469                                                                                                                        |
| Vendim i Bankës së Shqipërisë<br>nr. 49, datë 5.8.2020                                | Për miratimin e mbylljes së fazuar të aktivitetit të ndërmjetësimit të investimit të personave fizikë në bono thesari nëpërmjet Bankës së Shqipërisë..... 9469                                                                                           |
| Kërkesë e Ministrisë së<br>Infrastrukturës dhe Energjisë<br>nr. 2619/6, datë 7.8.2020 | Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i terreneve sportive në “Shkollën Kosova”, në Tiranë..... 9470                                                                                     |
| Kërkesë e Ministrisë së<br>Infrastrukturës dhe Energjisë<br>nr. 5911, datë 7.8.2020   | Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërhyrje në infrastrukturën e rrugëve ‘Andrea Papaj’, degëzimi 1 djathtas, degëzimi 2 djathtas”, Lushnjë..... 9472                  |
| Kërkesë e Ministrisë së<br>Infrastrukturës dhe Energjisë<br>nr. 5913, datë 7.8.2020   | Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rehabilitimi dhe sistemimi i shesheve brenda blloqeve të banimit, si dhe krijimi i hapësirave rekreative brenda tyre ‘Lagja 8 Shkurti’”..... 9472 |





## VENDIM

Nr. 647, datë 30.7.2020

**PËR NJË SHITESË FONDI NË  
BUXHETIN E VITIT 2020, MIRATUAR  
PËR MINISTRINË E KULTURËS, PËR  
MBULIMIN E SHPENZIMEVE  
KAPITALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Ministrisë së Kulturës, në buxhetin e saj të miratuar për vitin 2020, i shtohet fondi prej 149 000 000 (njëqind e dyzet e nëntë milionë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve kapitale.

2. Shtesa e fondit prej 149 000 000 (njëqind e dyzet e nëntë milionë) lekësh ndahet, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 08220 “Trashëgimia kulturore dhe muzetë”:

i. në zërin “Shpenzime kapitale”, llogaria 230, fondi prej 8 200 000 (tetë milionë e dyqind mijë) lekësh;

ii. në zërin “Shpenzime kapitale”, llogaria 231, fondi prej 109 800 000 (njëqind e nëntë milionë e tetëqind mijë) lekësh.

b) Në programin buxhetor 08230 “Art & kultura”, në zërin “Shpenzime kapitale”, llogaria 231, fondi prej 31 000 000 (tridhjetë e një milionë) lekësh.

3. Efekti financiar përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2020.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR  
Edi Rama**

## VENDIM

Nr. 49, datë 5.8.2020

**PËR MIRATIMIN E MBYLLJES SË  
FAZUAR TË AKTIVITETIT TË  
NDËRMJETËSIMIT TË INVESTIMIT TË  
PERSONAVE FIZIKË NË BONO  
THESARI NËPËRMJET BANKËS SË  
SHQIPËRISË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronjat “b” dhe “ç”, si dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

## VENDOSI:

1. Të mbyllë aktivitetin e ndërmjetësimit të investimit të personave fizikë në bono thesari nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, sipas fazave në vijim:

a) Në datën 1 janar 2021 të ndërpritet lidhja e kontratave të reja për pjesëmarrjen e tërthortë të personave fizikë në sistemin AFISaR;

b) Në datën 1 janar 2022 të ndërpritet ndërmjetësimi i investimit në bono thesari nga personat fizikë nëpërmjet Bankës së Shqipërisë.

2. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe Departamenti i Emisionit i Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR  
Gent Sejko**

**KËRKESË****Nr. 2619/6, datë 7.8.2020****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i terreneve sportive në “Shkollën Kosova”, në Tiranë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim dhe/ose për shkëmbim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak, të llogaritur si:

1. Për pasuritë e llojit “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

2. Për pasuritë e llojit “ndërtesë me funksion banimi” është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të

përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, bazuar në shkresën nr. prot. 58091/1, datë 5.6.2020, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore, Tiranë Jug.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit në Bashkinë Tiranë, si dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 76 213 135 (shtatëdhjetë e gjashtë milionë e dyqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e pesë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I  
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
**Artan Shkreli**



## LLOGARITJET PARAPRAKE PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I TERRENEVE SPORTIVE NË “SHKOLLËN KOSOVA”, NË TIRANË

| Nr.             | EMËR ATËSI<br>MBIEMËR                                                                  | ZK   | Nr. pas. | Sip. e<br>përgj.<br>trualli<br>(m <sup>2</sup> ) | Sip. e<br>prekur<br>trualli<br>(m <sup>2</sup> ) | Çmimi<br>për truall<br>(lekë/m <sup>2</sup> ) | Vlera, truall i<br>prekur (lekë) | Sip. e<br>gjurmës së<br>objektit,<br>sipas<br>kartelës<br>(m <sup>2</sup> ) | Sip. e përgj.<br>ndërtimi e<br>objektit, sipas<br>kartelës (m <sup>2</sup> ) | Sip. e prekur, objekt (m <sup>2</sup> ) |                                  | Çmimi për<br>objekt<br>banimi<br>(lek/m <sup>2</sup> ) | Vlera, sip.<br>prekur objekt,<br>shërbimi, me<br>situation (lek) | Vlera, sip. prekur,<br>objekt banimi (lek) | Vlera e përgj. truall<br>+ objekt (lek) | Konfirmim: ASHK Tiranë                                                                                                                                                      | Shënime                                                                                                                                                                                         |
|-----------------|----------------------------------------------------------------------------------------|------|----------|--------------------------------------------------|--------------------------------------------------|-----------------------------------------------|----------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|----------------------------------|--------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------|-----------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                 |                                                                                        |      |          |                                                  |                                                  |                                               |                                  |                                                                             |                                                                              | Sip.<br>shërbimi<br>(m <sup>2</sup> )   | Sip. banimi<br>(m <sup>2</sup> ) |                                                        |                                                                  |                                            |                                         |                                                                                                                                                                             |                                                                                                                                                                                                 |
| 1               | BP Tagani<br>(Kinete<br>Mehmet Tagani,<br>Arben Sami<br>Tagani, Xhelal<br>Sami Tagani) | 8160 | 2/330-ND | 0                                                | 0                                                | -                                             | -                                | 110.00                                                                      | 330.00                                                                       | 0.00                                    | 330.00                           | 172,198.82                                             | 0.00                                                             | 56,825,609.12                              | 56,825,609.1                            | Konfirmohet me shkresat nr. prot. 5829/3, datë 23.10.2019 dhe nr. prot. 5809/1, datë 5.6.2020, të ASHK-së Drejtoria Vendore, Tirana Jug                                     | Në kartelën e pasurisë, seksioni "Përshkrimi i veçantë" ka shënimin: "Objekt 3-katësh", dhe në seksionin "E" ka shënimin: "Ndërtesa ngrihet mbi truallin me nr. pasurie 2/330, vol. 47, f. 203" |
| 2               | Pronar i<br>pavërtetuar                                                                | 8160 | 2/330    | 234.5                                            | 234.5                                            | 66,969                                        | 15,704,230.50                    | 0.00                                                                        | 0.00                                                                         | 0.00                                    | 0.00                             | 0                                                      | 0                                                                | 0                                          | 15,704,230.50                           | Konfirmohet me shkresat nr. prot. 5809/1, datë 5.6.2020, të ASHK-së Drejtoria Vendore, Tirana Jug                                                                           | Në kartelën e pasurisë, në seksionin "E" ka shënimin: "Mbi këtë truall ngrihet ndërtesa me nr. pasurie ND-2/330, vol. 49, f. 96"                                                                |
| 3               | BP Tagani,<br>Saraçi                                                                   | 8160 | 2/165    | 36                                               | 36                                               | 66,969                                        | 2,410,884.00                     | 0.00                                                                        | 0.00                                                                         | 0.00                                    | 0.00                             | 0                                                      | 0.00                                                             | 0                                          | 2,410,884.00                            | Konfirmohet me shkresat nr. prot. 5829/1, datë 19.9.2019, nr. prot. 5829/3, datë 23.10.2019, dhe nr. prot. 5809/1, datë 5.6.2020, të ASHK-së, Drejtoria Vendore, Tirana Jug |                                                                                                                                                                                                 |
| 4               | Bashkia Tiranë                                                                         | 8160 | 2/76     | 2468.5                                           | 10                                               | -                                             | -                                | 748.00                                                                      | 0.00                                                                         | 0.00                                    | 0.00                             | 0                                                      | 0.00                                                             | 0                                          | -                                       | Konfirmohet me shkresat nr. prot. 5829/3, datë 23.10.2019 dhe nr. prot. 5809/1, datë 5.6.2020, të ASHK-së Drejtoria Vendore, Tirana Jug                                     |                                                                                                                                                                                                 |
| 5               | Artan Ferid<br>Tagani                                                                  | 8160 | 2/331    | 66.5                                             | 19                                               | 66,969                                        | 1,272,411.00                     | 0.00                                                                        | 0.00                                                                         | 0.00                                    | 0.00                             | 0                                                      | 0.00                                                             | 0                                          | 1,272,411.00                            | Konfirmohet me shkresat nr. prot. 5809/1, datë 5.6.2020, të ASHK-së Drejtoria Vendore, Tirana Jug                                                                           |                                                                                                                                                                                                 |
| 6               | Shtet                                                                                  | 8160 | 2/319    | 242                                              | 28                                               | -                                             | -                                | 0.00                                                                        | 0.00                                                                         | 0.00                                    | 0.00                             | 0                                                      | 0.00                                                             | 0                                          | -                                       | Konfirmohet me shkresat nr. prot. 966/1, datë 19.5.2020 dhe nr. prot. 5809/1, datë 5.6.2020, të ASHK-së, Drejtoria Vendore, Tirana Jug                                      | Shesh                                                                                                                                                                                           |
| 7               | Shtet                                                                                  | 8160 | 2/91     | 893                                              | 4                                                | -                                             | -                                | 0.00                                                                        | 0.00                                                                         | 0.00                                    | 0.00                             | 0.00                                                   | 0.00                                                             | 0                                          | -                                       | Konfirmohet me shkresat nr. prot. 5829/1, datë 19.9.2019, nr. prot. 5829/3, datë 23.10.2019, dhe nr. prot. 5809/1, datë 5.6.2020, të ASHK-së Drejtoria Vendore, Tirana Jug  | Trotuare                                                                                                                                                                                        |
| SHUMA PARAPRAKE |                                                                                        |      |          |                                                  | 331.5                                            |                                               |                                  |                                                                             |                                                                              |                                         |                                  |                                                        |                                                                  |                                            | 76,213,135                              |                                                                                                                                                                             |                                                                                                                                                                                                 |

**SHËNIM:**

1. Pasuritë e prekura nga projekti konfirmohen me shkresat nr. prot. 5829/1, datë 19.9.2019, nr. prot. 5829/3, datë 23.10.2019, nr. prot. 966/1, datë 19.5.2020 dhe nr. prot. 5809/1, datë 5.6.2020, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore, Tirana Jug.
2. Për truallin, çmimi i llogantur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.
3. Për objektet me funksion banimi, çmimi për llogaritje është marrë çmimi mesatar për objekt banimi vënë në dispozicionin tonë me shkresën nr. prot. 5809/1, datë 5.6.2020, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore, Tirana Jug.
4. Pasuria nr. 2/287, ZK 8160, në pronësi të bashkëpronarëve Ulqinaku dhe Shahu, e cila preket nga projekti, është hequr nga tabela e llogaritjeve paraprahe, pasi në shkresën nr. prot. 966/1, datë 19.5.2020, të ASHK-së, Drejtoria Vendore, Tirana Jug, konfirmohet pasuri e menaxhuar me leje zhvillimore, në favor të shoqërisë "DAJTI FN".

**KËRKESË****Nr. 5911, datë 7.8.2020****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërhyrje në infrastrukturën e rrugëve ‘Andrea Papaj’, degëzimi 1 djathtas, degëzimi 2 djathtas”, Lushnjë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasurinë e llojit “truall”, për pronarin sipas listës emërore bashkëlidhur.

- Vlera totale e shpronësimit është 136,996.00 (njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

**ZËVENDËSMINISTËR I  
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
Artan Shkreli**

LISTA E PRONARIT TË PASURISË, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHET NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT  
“NDËRHYRJE NË INFRASTRUKTURËN E RRUGËVE ‘ANDREA PAPAJ’ DEGËZIMI 1 DJATHTAS, DEGËZIMI 2 DJATHTAS, LUSHNJË”,  
VLERËSIMI I TOKËS TRUALL DHE TOKËS ARË ËSHTË LLOGARITUR BAZUAR NË VKM NR.89, DATË 3.2.2016

| Nr                     | Emër Mbiemër          | Lloji i Paturisë | ZK   | Nr. i pasurisë | Sip. totale m <sup>2</sup> | Sip. e shpronësuar m <sup>2</sup> | Çmimi (lek) | Vlera totale për shpronësim | Shënime                                                                                                            |
|------------------------|-----------------------|------------------|------|----------------|----------------------------|-----------------------------------|-------------|-----------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1                      | Harallamb Mihail Çeka | Truall           | 8572 | 14/138         | 760                        | 15.3                              | 8954        | 136,996.00                  | Konfirmuar nga ZVRPP-ja Lushnjë, me shkresën nr. 5064/1 prot., datë 5.7.2018 + vërtetimi hipotekar, datë 30.8.2018 |
| Vlera totale paraprake |                       |                  |      |                | 760                        |                                   |             | 136,996                     |                                                                                                                    |

**KËRKESË****Nr. 5913, datë 7.8.2020****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rehabilitimi dhe sistemimi i shesheve brenda blloqeve të banimit, si dhe krijimi i hapësirave rekreative brenda tyre ‘Lagja 8 Shkurti’”

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Fier.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 9 559 542 (nëntë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e dyzet e dy) lekë.

**ZËVENDËSMINISTËR I  
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
Artan Shkreli**

Lista paraprake e pronarëve të pasurive pronë private që shpronësohen, pasi preken nga realizimi i projektit:  
“Rehabilitimi dhe sistemimi i shesheve brenda blloqeve të banimit, si dhe krijimi i hapësirave rekreative brenda tyre ‘Lagja 8 Shkurti’”.

| Nr.                         | Emër Mbiemër                                                                                                                                                                                                                                                             | Zona Kadastrale | Nr/pasuri kë | Sipërfaqja totale | Sipërfaqja shpronësimi Tokë Truall / m <sup>2</sup> | Çmimi Tokë Truall / m <sup>2</sup> | Vlera totale / Lekë | Shënime Konfirmuar ose jo nga ZVRPP-ja |
|-----------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|--------------|-------------------|-----------------------------------------------------|------------------------------------|---------------------|----------------------------------------|
| 1                           | Bp. Aristoteli Kulari, Llaçi Kulari, Topi Maqina, Sila Çela, Mina Kulari, Indri Kulari, Pandeli Kulari, Zoi Kulari, Leonidha Kulari, Urani Kulari, Kalepi Gjika, Jorgjete Kulari, Jona Kolari, Llaçi Kulari, Dori Kulari, Imetlla Kulari, Harilla Kulari dhe Jani Kulari | 8533            | 3/277        | 550               | 550                                                 | 11,026                             | 6,064,100           | Konfirmuar nga ZVRPP                   |
| 2                           | Elman Matoku                                                                                                                                                                                                                                                             | 8533            | 3/275        | 317               | 317                                                 | 11,026                             | 3,495,242           | Konfirmuar nga ZVRPP                   |
| Vlera totale e shpronësimit |                                                                                                                                                                                                                                                                          |                 |              |                   |                                                     |                                    | 9,559,542           |                                        |



*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 56 lekë